

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga përdorimi në pronësi: Kadastra mbyll procesin për 522 Ha tokë bujqësore në Shijak
ADRESA	https://www.gazetatema.net/ekonomia/nga-perdorimi-ne-pronesi-kadastra-mbyll-procesin-per-522-ha-toke-bujqes-i586638
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 09:33:48 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 09:28:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e39ff7bffc928a2146fceed32d430fb20a1b0493c10c4ba026e9d4b05cecf5d0
TEKSTI	3fcdcdbfd264b4ed0579eab2db0a439b29db09980bbf982232004d66d6662ac7
PAMJA	856255527b0602fcbec63724a19c1294962029c02bbdf415967513ae43259d14f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	775fa141499c497a334947f4f456fd337c9e3e8da7d3aff1b46fee491a4b6a5d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	554d51ffe1583614fc44621ae1478dd51416957b577076ef62782afd72e64dbf
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/775fa141499c497a334947f4f456fd337c9e3e8da7d3aff1b46fee491a4b6a5d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 [English](#)

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 [English](#)



ie [Sekuestrohen dy celulare te paligjshem ne burgje, procedohen 8 persona nga perdorimi ne pronesi: Kadastra mbyll procesin per 522 Ha toke bujqesore ne Shijak](#) 41 vepra fundit

Nga përdorimi në pronësi: Kadastra mbyll procesin për 522 Ha tokë bujqësore në Shijak

 TemA

17 Shtator 2026, 11:28Ekonomia TEMA



Ajencia Shtetërore e Kadastrës ka avancuar procesin e kalimit të tokës bujqësore nga përdorimi në pronësi në fshatrat Shetel dhe Shahinaj, në Njësinë Administrative Gjepalaj, Bashkia Shijak, duke i hapur rrugë pajisjes së banorëve me dokumentin e pronësisë.

Në këto dy fshatra bëhet fjalë për rreth 522 hektarë tokë bujqësore, të ndarë në afro 1,300 parcela, të cilat janë në proces trajtimi nga strukturat e Kadastrës. Për të ndjekur nga afër këtë proces në zonë ishte e pranishme edhe drejtoresha e Përgjithshme e ASHK, Lorena Goxhobelli.

Për 630 parcela janë përgatitur tashmë vendimet, të cilat do të afishohen për një periudhë 30-ditore pranë Njesisë Administrative Gjepalaj. Gjatë kësaj periudhe, banorët do të kenë mundësinë të verifikojnë emrin, parcelën dhe të dhënat e tjera përkatëse. Pas përfundimit të afishimit, vendimet do t'i kalojnë për miratim Këshillit Bashkiak.

Procesi nuk është i kufizuar vetëm në Shijak. Paralelisht ASHK vijon punën për kalimin e tokës bujqësore nga përdorimi në pronësi në 59 fshatra në të gjithë vendin, duke përfshirë zona në Durrës, Vlorë, Has, Tropojë, Kukës, Dibër, Korçë, Lezhë, Berat, Shkodër, Elbasan, Fier dhe qarqe të tjera.

Në Orikum ndërkohë kanë nisur matjet në terren për 261 kërkesa, ndërsa puna vijon edhe në Cahan të Hasit, Fierzë të Tropojës, Shtiqen të Kukësit dhe Zalldardhë të Dibrës. Në Dibër, procesi është shtrirë në njësitë administrative Zall Dardhë dhe Derjan, ku përfshihen 16 fshatra.

Deri më tani janë kaluar përmes vendimeve të miratuara rreth 107 hektarë tokë, ndërsa vetëm kërkesat që janë aktualisht në proces pune përfshijnë rreth 300 hektarë tokë bujqësore, që pritet t'u kalojë në pronësi përdoruesve të saj.

Procesi kërkon verifikime dhe matje në terren, administrimin e dokumentacionit dhe bashkëpunimin me njësitë e qeverisjes vendore. Për këtë, Kadastra u bën thirrje banorëve të bashkëpunojnë me ekipet që janë në terren dhe të jenë të pranishëm kur nis puna në zonat e tyre.

Po ashtu, banorëve u kërkohet që gjatë periudhës së afishimit të vendimeve të kontrollojnë emrin, parcelën dhe të dhënat e tjera, në mënyrë që çdo pasaktësi eventuale të konstatohet në kohë.

Synimi i këtij procesi është përfundimi i procedurave të kalimit të tokës bujqësore nga përdorimi në pronësi dhe pajisja me dokumentacion pronësie e familjeve që e kanë përdorur prej vitesh këtë tokë.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Vendimet e qeverisë/ Karakaçi: Rezerva e sigurisë së hidrokarbureve do të menaxhohet nga shteti, nis puna për mbikalimet në Kashar dhe Yrshek

15:20 Ekonomia

Rritja e çmimit të naftës, ministria Ibrahimaj njofton ringritjen e Bordit të Transparencës

14:30 Ekonomia , 5 komente

[ABI Bank konsolidon rritjen në gjashtëmuajorin e parë 2026](#)

10:47 Ekonomia



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.